



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-4240/20 datë:18.02.2020



Npi – 01/56 datë: 27.02.2020

Duke u bazuar në nenet 12 pika (d), dhe 68 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.03/L-040; Ligji Nr.03/L-164, dt.04.2010 për financimin e programeve të veçanta të banimit; Nenin 10.4 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së, për Transparencë në Komuna Nr.04/2018; Udhëzimi Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna Nr.06/2018; Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më 27.02.2020, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR TA NXJERRË NË DISKUTIM PUBLIK
DRAFT-PROGRAMIN KOMUNAL PËR BANIM PËR PERIUDHËN 2020-2022

I

Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -II- të rregullt për vitin 2020, të mbajtur më: 27.02.2020, unanimisht aprovoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft-Programin Komunal për Banim për periudhën 2020-2022, në afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Shëndetësi, dhe Mirëqenie Sociale në bashkëpunim me Zyrën për Informim.

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj